



Periodiku AMF

Miratohen në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, ligjet “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Kuvendi i Shqipërisë, më datë 10 dhjetor 2009, miratoi në seancë plenare, Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-nëntor 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor arritën shifrën 7,151,729 mijë lekë, përkundëjt 6,535,515 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 9.43% më shumë.

Vijon në faqen 5

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Risiguruesit botërorë mbeten të fortë përkundër sfidave

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), dhjetor 2009)

Tregu botëror i risigurimeve ka treguar pozita të forta dhe rezistencë përkundër vështirësive të shkaktuara nga humbjet katastrofike të vazhdueshme dhe investimet e ulëta gjatë vitit 2008.

Vijon në faqen 8

Udhëzime për entet rregullatore të tregjeve të reja, me kërkesat minimale për hyrjen dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të mbështetur në rrezik të ndërmjetësve të tregjeve

Përmbledhje ekzekutive

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), dhjetor 2009)

Gjatë dy dekadave të fundit ka pasur një rritje dhe dinamizëm të ndjeshëm në tregjet globale të kapitalit. Kjo rritje krijoi tregje, bursa dhe ndërmjetës të rinj dhe çoi edhe në lindjen e produkteve dhe instrumenteve financiare gjithnjë e më komplekse.

Vijon në faqen 8

Edukimi i konsumatorit

...Vijon nga numri i kaluar

Prezantim i Industrisë së Sigurimeve, botim i Rodney Lester

(Material i nxjerrë nga faqja e Bankës Botërore, mars 2009)

Liberalizimi

Ekziston një presion i madh mbi vendet në tranzicion për të hapur sektorët e tyre lokalë të sigurimeve drejt konkurrencës ndërkombëtare, edhe pse kjo do të thotë vetëm aftësi për të krijuar një filial lokal ose sipërmarrje të përbashkët. Ky presion vjen prej burimeve të ndryshme, megjithëse negociatat e WTO (GATS) priren të jenë faktori i përmendur më shumë.

Vijon në faqen 10

Në këtë numër:

Miratohen në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, ligjet “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

5

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

8

Edukimi i konsumatorit

10

Miratohen në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, ligjet “Për fondet e pensionitvullnetar” dhe “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Kuvendi i Shqipërisë, më datë 10 dhjetor 2009, miratoi në seancë plenare, Ligjin nr. 10 197 , datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

I. Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" u hartua me qëllim përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare në Shqipëri me ndikime të pritshme, në:

- lehtësimin në planin afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Ky ligj përmban disa risi, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, duke ndryshuar skemën aktuale të funksionimit të kolonës së tretë. Në qendër të skemës së propozuar është vendosur shoqëria administruese, e cila do të administrojë dhe investojë fondet e pensioneve, duke u udhëhequr vetëm dhe ekskluzivisht nga interesi më i mirë i anëtarëve të fondit të pensionit.
- Përcakton në përputhje me Direktivat Evropiane kërkesat e vendosura për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë administruese. Struktura ligjore e shoqërisë

administruese është përcaktuar në këtë ligj dhe ajo themelohet si shoqëri aksionare.

- Ndan konceptin e administrimit të fondit nga vetë fondi i pensionit. Fondi i pensionit është konceptuar si një grup asetesh, i krijuar mbi bazë kontrate. Ligji rregullon të gjitha procedurat e anëtarësimit, pezullimit të anëtarësimit, transferimit në një fond tjetër pensioni dhe tërheqjes nga fondi I pensionit.
- Parashikon detyrimin e shoqërisë administruese, për të depozituar asetet e fondit në një depozitar, duke përcaktuar në detaj shërbimet që ofron ky i fundit. Shërbimet e depozitarit mund të kryhen vetëm nga banka. Funksionet dhe detyrat kryesore të depozitarit janë ruajtja e aseteve të fondit dhe garantimi i llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit. Depozitari nuk mund të jetë palë e lidhur me shoqërinë administruese.
- Sjell një koncept të ri mbi kriteret që duhet të plotësojnë aksionarët dhe administratorët e shoqërisë administruese, duke parashikuar se ata duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm (fit and proper) për të marrë përsipër këto role. Ligji ka parashikuar dispozita të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit për këta persona gjatë ushtrimit të roleve të tyre në shoqërinë administruese. Në këtë mënyrë, ligji ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së këtyre personave, të cilët administrojnë kontributet në fondet e pensionit vullnetar.
- Parashikon lehtësira tatimore, me qëllim nxitjen e shtetasve shqiptarë për të kontribuar në fondet e pensionit vullnetar. Krahas parashikimit të të drejtave të anëtarëve, parashikon edhe lehtësirat tatimore që u ofrohen vetë anëtarëve, si dhe individëve të tjerë që kontribuojnë në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensioni vullnetar. Nxitet pjesëmarrja duke futur politikën e lehtësirave tatimore sipas modelit EET^[1] që

nënkupton tatim vetëm në momentin e marrjes së përfitimit. Këto lehtësira fiskale të propozuara, nuk kanë ndikim negativ në situatën aktuale buxhetore, pasi fondet private të pensioneve janë akoma në një stad të vogël zhvillimi. Përfitimet, në aspektin social dhe investimet afatgjata në ekonomi, kompensojnë efektet e lehtësimit fiskal në të ardhmen.

- Në ligj janë parashikuar politikat e investimit të shoqërisë administruese, të cilat janë hartuar në përputhje me parimet e diversifikimit të riskut duke pasur parasysh edhe mësimet nga kriza aktuale financiare botërore. Në këto dispozita rëndësi u është kushtuar përcaktimit të klasave të investimeve të pa lejuara, duke shprehur në këtë mënyrë detyrimin e qartë të shoqërisë administruese për të mos investuar në instrumente financiare që nuk janë të listuar ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndër bankar ose në tregje të tjera të rregulluara nga autoritetet përkatëse.
- Forcon rolin e Autoritetit në mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve nëpërmjet parashikimit të masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj të gjithë të licencuarve. Dispozitat rregullojnë gjithashtu vendosjen nën administrim të veçantë të të licencuarve, të drejtën e pezullimit të licencës ose revokimit të licencës, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë administruese. Mënyra e re e mbikëqyrjes, përqendrohet në mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit, në përmirësimin e mirëqeverisjes, besueshmërisë dhe transparencës së shoqërisë administruese, duke trajtuar me vëmendje më të madhe çështjet që paraqesin risk më të lartë. Kompetencat mbikëqyrëse të AMF-së janë hartuar në përputhje me parimet e mbikëqyrjes së pensioneve private sipas udhëzimeve të IOPS^[2].
- Pjesë e rëndësishme e këtij ligji janë dhe dispozitat për shkëmbimin e informacionit me autoritete homologe dhe ruajtja e

konfidencialitetit në respektim të jetës private të çdokujt.

- Parashikon dhe vepra të reja penale si dhe sanksionet përkatëse. Shkelja e detyrimeve ligjore nga të licencuarit sipas këtij projektligji do të përbëjë vepër penale dhe do të dënohet me gjobë ose burgim kur kjo vepër ka sjellë pasojë të rënda.

Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "*Për fondet e pensionit vullnetar*", është hartuar në përputhje me direktivat/rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe me udhëzimet e OECD^[3] - IOPS për administrimin e fondeve të pensionit suplementar vullnetar.

Aktorët pjesëmarrës në hartimin e këtij ligji janë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe ekspertë të Bankës Botërore dhe ekspertë lokale.

II. Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" është një përpjekje serioze për të trajtuar dhe rregulluar investimin masiv të kursimeve në ekonomi përmes skemave të investimit kolektiv në portofole titujsh.

Qëllimi i këtij ligji është plotësimi i kuadrit ligjor në fushën financiare, fokusuar në tregun e titujve, në përputhje me standardet bashkëkohore, si një domosdoshmëri që i përgjigjet zhvillimeve aktuale në vend. Ligji synon të krijojë një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar për të nxitur zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Investitorët në sipërmarrjet e investimeve kolektive janë individë dhe institucione financiare, dhe secili prej këtyre grupeve të interesit kanë nevojë për nxitje, për të investuar. Investitorët individë zakonisht janë të prirur drejt investimeve afatshkurtër, ndërkohë që investitorët institucionalë zakonisht janë të prirur të jenë pjesë e strategjive të investimeve afatgjata në tregun e titujve, pra në bursë, duke ndihmuar kështu në krijimin e një tregu të

qëndrueshëm. Vënia në zbatim e këtij ligji do të krijojë pikërisht hapësirën e duhur për zhvillimin dhe rritjen e tregut të titujve.

Një nga objektivat kryesorë të ligjit është të sigurojë një mbrojtje efektive të interesave të investitorëve, të cilët nxiten nga ofertat e operatorëve të këtyre sipërmarrjeve. Për këtë qëllim, ligji parashikon ndalimin e promovimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në publik, për sa kohë që nuk janë licencuar nga AMF. Asnjë shoqëri administruese nuk mund të fillojë promovimin, reklamimin, tregtimin, ose ofertën për shitje të kuotave apo aksioneve të një sipërmarrjeje investimi kolektiv pa autorizimin e AMF-së.

Ligji përcakton kushtet dhe kriteret për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese të tyre, si dhe rregullon çështje të tilla si emetimin dhe shitjen e kuotave, llogaritjen e vlerës neto të kuotave, shlyerjen e tyre; promovimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive; veprimtaritë e kryera nga palët e treta për llogari të sipërmarrjeve të investimeve kolektive; realizimin e mbikëqyrjes nga ana e AMF-së mbi veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese, depozitarët dhe personat e përfshirë në shitjen e kuotave dhe aksioneve.

Ky ligj përmban disa risi, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Parashikon dy lloje të sipërmarrjes së investimeve kolektive, njëra e emërtuar "*Fond Investimi*", që nënkupton një fond me pjesëmarrje të hapur, i krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave. Lloji i dytë i sipërmarrjes së investimeve kolektive është "*Shoqëria e Investimit*", që nënkupton një sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur, e themeluar si shoqëri aksionare në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e cila mund të jetë me ofertë publike ose me ofertë private dhe aktiviteti i

vetëm tregtar i së cilës do të konsistojë në kryerjen e investimeve sipas kërkesave të projektligjit.

- Ligji i jep një rol thelbësor shoqërisë administruese të sipërmarrjeve kolektive. Ai parashtron standarde bashkëkohore për kriteret që duhet të plotësojnë aksionarët dhe administratorët e shoqërive administruese duke parashikuar se ata duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm për të marrë përsipër këto role, përmban dispozita të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit për këta persona gjatë ushtrimit të roleve të tyre në shoqërinë administruese. Në këtë mënyrë, ligji ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së personave, të cilët administrojnë fondet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.
- Sanksionon krijimin e regjistrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (regjistri i fondeve) i cili do të mbahet nga Autoriteti dhe është i hapur për publikun. Ky regjistër mundëson një transparencë më të plotë ndaj investitorit në veçanti dhe ndaj publikut të gjerë në përgjithësi.
- Kujdes i veçantë është treguar në lidhje me politikat e investimit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, duke përfshirë investimet e lejuara dhe kufizimet e investimit. Duke pasur parasysh kërkesat e Direktivës së BE-së, është siguruar zbatimi i parimit të diversifikimit dhe kujdesit në investim. Sipërmarrjet e investimeve kolektive sipas këtij ligji, vendosen në pozitë të barabartë me simotrat Evropiane, përsa i përket kushteve në politikat e investimit, përfshirë mundësinë për të investuar në tregje jashtë Shqipërisë.
- Përfshin disa problematika të veçanta të tilla si detyrimet e agjentëve, procedurat për të ofruar mundësi investimi në Shqipëri nga subjektet e një shteti anëtar të Bashkimit

Evropian dhe anasjelltas, rregulla për marketimin dhe promovimin për sipërmarrje të investimit kolektiv, etj.

- Një trajtim i veçantë është bërë për depozitarin. Dispozita të ligjit shmangin konfliktet e mundshme të interesit ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese, përcaktohet që këta të mos jenë të lidhur me njëri-tjetrin dhe që në veprimtarinë e tyre të mos angazhohen të njëjtët persona.
- Përmban dispozita të detajuara në lidhje me mbikëqyrjen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të sipërmarrjeve kolektive të investimit, shoqërive administruese të tyre, depozitarëve, etj. Standardet e parashikuara të mbikëqyrjes janë në përputhje me frymën e ligjit të AMF-së, dhe standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes në tregjet e titujve. Ligji parashikon sanksione të përshkallëzuara në rast të thyerjes së dispozitave ligjore.

Në bazë të dispozitave tranzitore, Ligji "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" shfuqizon ligjin e vjetër në fuqi, Ligjin nr. 7979, datë 26.7.1995, "Për fondet e investimit".

Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" është një shprehje e qartë e vullnetit dhe angazhimit të Republikës së Shqipërisë për përafrimin e ligjeve të saj me ato të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye disa nene të veçanta i janë kushtuar edhe shoqërive administruese me seli të regjistruar në një vend të BE-së, të cilat duan të themelojnë një degë në Republikën e Shqipërisë, duke ju ofruar shoqërive të huaja në këtë mënyrë të drejtën për t'u vendosur në Shqipëri dhe për mos t'u trajtuar ndryshe nga shoqëritë e tjera vendase.

Ligji në fjalë, është hartuar në përputhje me Direktivën 85/611/EEC, që rregullon fondet e investimeve, të datës 20 dhjetor 1985 "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe parashikimeve administrative lidhur me

sipërmarrjet për investimet kolektive me tituj të transferueshëm", e cila ka për qëllim harmonizimin e ligjeve, rregulloreve dhe parashikimeve administrative për sipërmarrjet e investimeve kolektive me tituj të transferueshëm. Nisur nga risitë dhe përmirësimet që sollën, Kuvendi i Shqipërisë, i miratoi me të gjithë votat e deputetëve të pranishëm në sallë. Këto dy ligje priten të dekretohen nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

- [1]. EET qëndron për shkurtimet në gjuhën Angleze, Exempt, Exempt, Taxed, që do të thotë përjashtim nga taksat në momentin e pagesës së kontributeve, përjashtim nga taksat të kthimit nga investimi dhe taksim në momentin e marrjes së përfitimit/pensionit.
[2]. Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve
[3]. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar - nëntor 2009


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor arritën shifrën 7,151,729 mijë lekë, përkundrejt 6,535,515 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 9.43% më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 46.31% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 53.69% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 39.53% të sigurimeve të Jetës dhe 7.12% të sigurimeve të Jo-Jetës.


Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 90.93% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës.

Gjatë 11-mujorit të vitit 2009 u nënshkruan rreth 692,941 kontrata sigurimi, ose rreth 9.78% më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.

Struktura e tregut të sigurimeve,
janar - nëntor 2009




Struktura e tregut të sigurimeve,
janar - nëntor 2009



Volumi i primit të shkruar bruto, janar - nëntor (2008-2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Periudha janar - nëntor	2008	2009
A) Sigurim i Jetës	464,994	648,823
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,070,521	6,502,906
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,656,396	3,839,839
b) Sigurimi Vullnetar	2,414,125	2,663,067
TOTAL	6,535,515	7,151,729

Volumi i primit të shkruar bruto,
janar - nëntor 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-nëntor 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 53.69% të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, për 11-mujorin e vitit 2009, arritën 2,490,614 mijë lekë, ose 0.90% më pak se në periudhën janar-nëntor 2008.

Në janar-nëntor 2009, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 998,067 mijë lekë, ose rreth 16.47% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 11-mujorit 2009 arritën në 351,158 mijë lekë, apo 22.70% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2008.

Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar-nëntor 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,311,890 mijë lekë, ose 15.03% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,663,067 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 27.79%, të pasuara nga siguri kasko me 21.37% dhe siguri i përgjegjësisë të përgjithshme civile me 18.18% e peshë më të ulët patën siguri i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.



Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-nëntor 2009 arritën në 353,225 mijë lekë, ose 24.53% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75.51% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në 11-mujorin e vitit 2009 arritën në rreth 648,823 mijë lekë, ose rreth 39.53% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.76% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan



kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.97% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-nëntor 2009 kapi vlerën 1,548,930 mijë lekë, ose 10.30% më shumë se në janar-nëntor të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 1,343,222 mijë lekë, apo 86.72% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 13.68% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 8.25%, krahasuar me periudhën janar-nëntor të vitit 2008.

Risigurime

Gjatë periudhës janar-nëntor 2009, shoqëritë e sigurimit kanë lidhur kontrata me vlerë mbi 72,059 mijë lekë, të cilat i përkasin sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko”.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera**Risiguruesit botëror ngelen të fortë
përkundër sfidave**

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), dhjetor 2009).

Tregu botëror i risigurimeve ka treguar pozita të forta dhe rezistencë përkundër vështirësive të shkaktuara nga humbjet katastrofike të vazhdueshme dhe investimet e ulëta gjatë vitit 2008. Ky është një konstatim kryesor i Raportit të Shoqatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) “Tregu botëror i risigurimeve, 2009”, botuar së fundmi.

Risiguruesit luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e tregjeve efçente të sigurimeve, përmes kapacitetit amortizues të tyre, përfshirë edhe mbulimin kundër katastrofave natyrore të mëdha, të risiguruara. Raporti mbështetet në të dhënat unike që japin 51 risigurues kryesues global të mbarë botës, të cilët janë angazhuar aktivisht me IAIS, për rritjen e njohurive për risigurimin në mënyrë që të kuptohet, rregullohet dhe mbikëqyrret më mirë ky sektor kyç financiar.

Pas kushteve të vështira të vitit 2008, risiguruesit patën një rezultat të përgjithshëm pozitiv, çka tregon fuqinë e këtij sektori dhe ndihmon si në stabilitetin e tregjeve globale të sigurimeve, ashtu edhe në sigurinë e klientëve individualë të sigurimeve. Risiguruesit vazhduan të përqendrohen në marrjen e rreziqeve të diversifikuara, duke u mbështetur në aspektet themelore të aktivitetit të risigurimeve, në mënyrë që të kalohet një vit veçanërisht

problematic për ekonominë, në përgjithësi, dhe për sektorin financiar, në veçanti.

Sipas Jeremy Cox, Kryetar i Nëngrupit për Transparencën e Risigurimeve në grupin e punës së ngarkuar për studimin “risiguruesit kanë pësuar relativisht më pak dëme sa u takon aktiveve në bilancet e tyre në vitin 2008, në krahasim me sektorët e tjerë financiarë”, ndërsa sipas Peter Braumüller, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS, “përkundër turbullirës financiare të tanishme, tregu global i risigurimeve ka treguar pozita të shëndosha dhe rezistencë”. IAIS do të vazhdojë të ushtrojë një mbikëqyrje të matur në nivel makro të këtij sektori, duke ndjekur me kujdes rreziqet dhe prirjet kyçe në fushën e risigurimeve dhe duke i ndarë konstatimet me bashkësinë mbikëqyrëse ndërkombëtare.

**Udhëzime për entet rregullatore të tregjeve
të reja, me kërkesat minimale për hyrjen
dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të
mbështetur në rrezik të ndërmjetësve të
tregjeve****Përmbledhje ekzekutive**

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), dhjetor 2009)

Gjatë dy dekadave të fundit ka pasur një rritje dhe dinamizëm të ndjeshëm në tregjet globale të kapitalit. Kjo rritje krijoi tregje, bursa dhe ndërmjetës të rinj dhe çoi edhe në lindjen e produkteve dhe instrumenteve financiare gjithnjë e më komplekse.

Përmirësimet strukturore ndihmuan në zhvillimin e strukturave financiare të mëdha dhe komplekse, nxitën strukturimin financiar dhe shfrytëzuan rrugë të reja të përdorimit të levës financiare, çka u shoqërua me një oreks më të madh për rreziqe dhe me ndërthurje me teknologjinë e informacionit. Edhe mbikëqyrja e këtyre

strukturave komplekse bëri lëvizje paralele për të përmbushur kërkesat e nevojave të reja, duke u zhvilluar nga një stad ku theksi në fillim ishte te siguri i respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore, në një stad me një qasje më të plotë të strukturuar për të siguruar administrimin e duhur të gjithë rrezeve që shoqërojnë institucionet komplekse.

Ky skenar tregu në zhvillim, i ndërthurur me nevojën për një shpërndarje më të mirë të burimeve të kufizuara të mbikëqyrjes, i shtyu entet rregullatore të gjejnë metoda të përmirësuar të identifikimit, matjes dhe zbutjes së rrezeve me të cilët përballen lloji i ri i pjesëmarrësve në treg dhe produktet e reja financiare. Rrjedhimisht, një numër gjithnjë e më rritje i anëtarëve të IOSCO-s po largohen nga një sistem rregullues i mbështetur në norma për të kaluar drejt një sistemi i cili mbështetet më shumë në kompetencat e vendimmarrjes dhe gjykimin profesional të entit mbikëqyrës, përmes përdorimit të një strukture mbikëqyrëse të mbështetur në rrezik. Kjo përfshin licencimin (kërkesat minimale për hyrjen) dhe kërkesat për kapitalin, kuadrin për vlerësimin e rrezeve dhe metodikat e kontrollit.

Mbledhja e Komitetit të Tregjeve të Reja (KTR) të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), zhvilluar më 5 dhjetor 2007, në Dubai, i dha mandat Grupit të Punës 3 të KTR-së për Mbikëqyrjen e Ndërmjetësve të Tregjeve, për të përgatitur për entet rregullatore të tregjeve të reja, *Udhëzime për Kërkesat Minimale për Hyrjen dhe për Mbikëqyrjen e Vazhduar të Mbështetur në Rrezik të Ndërmjetësve të Tregjeve*.

Mbikëqyrja e ndërmjetësve të tregjeve ka tre objektiva të gjerë: mbrojtja e aseteve të klientëve nga falimentimi i ndërmjetësit, përvetësimi prej ndërmjetësit apo punonjësit të ndërmjetësit; mbrojtja nga mosshlyerja e detyrimeve dhe krizat e papritura në treg, ose përmes falimentimit të menjëhershëm ose përmes mosshlyrjes; dhe që ndërmjetësit të jenë të drejtë

dhe korrekt në marrëdhëniet me klientët e tyre. Rrjedhimisht, rregullimi vendos standarde për licencimin (duke kufizuar tregun për ata që kanë burime dhe kualifikime të pamjaftueshme), standarde të maturisë (duke ofruar mbrojtje nga kriza e beftë financiare), standarde për kontrollin e brendshëm dhe administrimin e rrezikut (duke e zvogëluar mundësinë e mosshlyerjes apo të përvetësimit të aseteve të klientëve) dhe norma për sjelljen tregtare (duke siguruar trajtimin e duhur të llogarive të klientëve).

Mirëpo, edhe pse mbikëqyrja e mbështetur në rrezik ofron shpresën e një regjimi më elastik dhe më të fokusuar, i cili mund t'u përshtatet zhvillimeve të shpejta të tregjeve, kjo mbikëqyrje ushtron trysni mbi entet mbikëqyrëse nga të cilët pritet t'i marrin në dorë këto sfida të reja përmes:

- o përdorimit të lirisë së enteve mbikëqyrëse për të marrë vendime;
- o drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare; dhe
- o analizës së administrimit që subjektet e mbikëqyrura u bëjnë rrezeve.

Për ta përmbushur mandatin e caktuar, Grupi i Punës 3 realizoi një vërtetim të juridiksioneve anëtare të KTR-së për t'i analizuar praktikën dhe metodat e tyre për *Kërkesat Minimale të Hyrjes dhe Mbikëqyrjen e Vazhdueshme të Mbështetur në Rrezik për Ndërmjetësit e Tregjeve*. Rezultati i vërtetimit zbuloi se mbikëqyrja e ndërmjetësve është një fushë e cila lipset të fuqizohet nga entet rregullatore. Megjithatë kërkesat minimale të hyrjes që janë vendosur në thuajse të gjitha juridiksionet e vërtetuara, përmes standardeve për licencimin, dhe megjithatë ekziston njëfarë forme kuadri mbikëqyrës, shumë ente rregullatore ende lipset ta përmirësojnë mbikëqyrjen e tyre të efektshme të aktivitetit të ndërmjetësve dhe të kërkojnë vendosjen e standardeve të hollësishme për sistemet e kontrollit të brendshëm dhe administrimin e rrezeve, krahas kërkesave kryesore të maturisë.

Në këtë raport trajtohen standardet e hyrjes dhe

kuadri i mbikëqyrjes i mbështetur te rreziku, për ndërmjetësit e tregjeve në vendet anëtare të Komitetit të Tregjeve të Reja. Në bazë të një studimi të metodave të mbikëqyrjes të mbështetura në rrezik, të ndjekura nga entet rregullatore të letrave me vlerë në tregjet e reja, Grupi i Punës 3 nxori një esencë të metodave/udhëzimeve për mbikëqyrjen e mbështetur në rrezik. Enteve të veçanta rregullatore do t'u kërkohet t'i përshtatin këto metoda të mbikëqyrjes të mbështetur mbi rrezikun, për t'ua përshtatur rrethanave konkrete të tregjeve të tyre.

Udhëzim për mbikëqyrjen e mbështetur në rrezik

1. planifikimi sistematik për qasjen e mbikëqyrjes së mbështetur në rrezik;
2. identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve përkatëse; dhe
3. shpërndarja e duhur e burimeve mbikëqyrëse.

Grupi i Punës 3 i KTR-së e pranon se vënia në zbatim e mbikëqyrjes së mbështetur në rrezik nuk do të jetë pa vështirësi. Disa prej sfidave të identifikuar lidhen me boshllëkun në aftësitë e personelit rregullator, aftësinë për të identifikuar dhe përkufizuar llojet e rreziqeve përkatëse dhe masat për zbutjen e rreziqeve, me marrjen e informacionit për profilet e plota të rrezikut të ndërmjetësve të tregjeve të kapitaleve, subjektivitetin e përfshirë në vlerësimin e rreziqeve dhe me zbatimin e një metodike uniforme për vlerësimin me pikë të rreziqeve në të gjitha institucionet financiare.

Enteve rregullatore do t'u duhet të rrisin kapacitetet për t'ua dalë mbanë këtyre sfidave të reja.

Edukimi i konsumatorit

...Vijon nga numri i kaluar

Prezantim i Industrisë së Sigurimeve, botim i Rodney Lester

(Material i nxjerrë nga faqja e Bankës Botërore, mars 2009)

Liberalizimi

Ekziston një presion i madh mbi vendet në tranzicion për të hapur sektorët e tyre lokalë të sigurimeve drejt konkurrencës ndërkombëtare, edhe pse kjo do të thotë vetëm aftësi për të krijuar një filial lokal ose sipërmarrje të përbashkët. Ky presion vjen prej burimeve të ndryshme, megjithëse negociatat e WTO (GATS)^[1]. prirjen të jenë faktori i përmendur më shumë. Disa vende kanë rënë dakord të hapin sektorët e tyre të sigurimeve, nganjëherë si një tregti për rritjen e aksesit për mallra në tregjet e zhvilluara ose për të shmangur vëmendjen nga sektori bankar. Fatkeqësisht, për shkak se sektori i sigurimeve është i vogël, liberalizimi është shpesh i nxituar dhe i menduar jo mirë, duke tërhequr sigurues të huaj të klasës së mesme (nëse ka një të tillë) ose nuk ndodh transferim i teknologjisë. Hapat kryesore, të cilat duhet të ndërmerren përpara se të bëhet hapja e tregut të sigurimeve, përfshijnë forcimin e regjimit rregullativ dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve mbikëqyrëse, zhvillimin e nevojshëm të aftësive dhe standardeve lokale (kontabilizimi, auditimi aktuarial) dhe privatizimi, ose të paktën korporatizimi i çdo siguruesi i kontrolluar ose me pronësi shtetërore. Gjithashtu mund të jetë e nevojshme për të vendosur klasat e detyrueshme të sigurimeve si MTPL nën një bazë të shëndoshë financiare dhe operacionale.

Integrimi ose bashkëpunimi i mbikëqyrësit financiar
Ndërkohë që është joshëse të aplikohet një përjasje “e njëjtë për të gjithë” (eng. “one size fits all”) për koordinimin e mbikëqyrjes, eksperiencat e deritanishme tregojnë që çdo vend është i

ndryshëm dhe një shkallë e caktuar kujdesi nevojitet para se të bëhet çdo rekomandim i konsiderueshëm. Në vendet e vogla shpesh ka ndodhur një tendencë drejt zhvendosjes së gjithë mbikëqyrjes së sektorit financiar nga banka qendrore dhe aty ku kjo ka ndodhur, në përgjithësi, rezultatet kanë qenë inkurajuese. Megjithatë, shpesh bankat qendrore reduktojnë mundësinë dhe në këtë pikë është më mirë të mos jemi specifike në opsione. Ndërkohë që nevoja për një koordinim më të madh mund të shfaqet në mënyrë të natyrshme nga çdo vlerësim i plotë dhe i arsyeshëm duke përdorur disa ose të gjithë ICP – të (Insurance Core Principles - Parimet Kryesore të Sigurimeve) e IAIS, rruga më e sigurtë është të krijohet një grup pune për të parë nevojat dhe opsionet dhe më pas të zhvillohet një plan i detajuar, mundësisht me mbështetje teknike.

Risk i katastrofës

Shumë vende në zhvillim dhe në tranzicion janë subjekt i risqeve të mëdha të katastrofave natyrore. Megjithatë, zhvillimi i pakët i tregjeve lokale të sigurimeve mund të kufizojë mundësitë për të transferuar riskun për arsye të penetrimit të kufizuar ose madje dhe të papërfillshëm në sektorët e ekonomisë familjare dhe të NVM (Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme). Përveç kësaj, ekziston një madhësi e caktuar e siguruesit, direkt, poshtë të cilës siguruesit ndërkombëtarë nuk mund ta mbështesin dhe justifikojnë për arsye të kostove të kryerjes së transaksionit. Nga Banka Botërore dhe organizata të tjera zhvillimi, janë krijuar një numër strukturash dhe janë zhvilluar një numër produkte për të plotësuar këtë boshllëk.

Kontabiliteti dhe sistemet e informacionit

Kontabiliteti në sigurime duhet të jetë mbi bazën e të drejtave të konstatuara, bazuar mbi një informacion kuptimplotë, i cili duhet të gjenerohet. Kjo do të thotë se pjesa e primeve të pafituara në datën e kontabilizimit, duhet të bëhet rezervë bashkë me vlerën aktuale të detyrimeve të dëmeve të ardhshme. Kjo shumë e

fundit mund të jetë thjesht një shtesë në dosjet e dëmeve të papaguara, me një rregullim mekanik për dëmet e ndodhura por jo të raportuara, ose llogaritjeve shumë komplekse të bazuara në modele në rastin e sigurimeve në afat të gjatë dhe klasave të sigurimit të jo-jetës, në të cilat dëmet kërkojnë një kohë të gjatë për t'u stabilizuar dhe zgjidhur (siç janë për shembull kompensimi i një dëmi të një punonjësi që lidhet me paralizën e pjesshme ose totale). Të ardhurat duhet të reflektojnë ndryshimet në primet e pafituara, dhe ndryshimet në kostot e dëmeve në rezervat dhe provigjonet për dëmet. Një modul mbi kontabilitetin rrjedhës në sigurime trajtohet më pas në këtë publikim.

Historikisht, procesi i rezervave është kryer nga aktuarët, të cilët priren të krijojnë marzhe substanciale sigurie. Gjithashtu, aktivet janë mbajtur në vlerën më të ulët të bilancit ose tregut, duke krijuar kështu marzhe të tjera sigurie. Gjithsesi, doktrina e kontabilizimit tani kërkon që fitimet e raportuara të jenë një përfaqësim i mirë i realitetit dhe ajo shpërndarje shtesë tek policëmbajtësit dhe pronarët të jetë e kapitalizueshme gjatë viteve. Kjo ka çuar në një kërkesë që aktivet të mbahen me vlerën e “drejtë” (e cila është, vlerë tregu për aktivet e listuara) sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Vlerësimi i detyrimeve është gjithashtu i konceptuar të jetë me “vlerë të drejtë”, por si pasojë e mungesës së një tregu efektiv të detyrimeve të sigurimit, kuptimi i këtij koncepti mbetet i paqartë.

Një nga standardet kryesore të kontabilitetit në sigurime (IFRS4 - Kontratat e sigurimeve) aktualisht është gjysmë i vendosur dhe versioni i tij final ka mundësi që deri në fillim të 2012 të mbetet i papërfunduar. Në të përkohshmen Solvency II, metoda e BE për kontrolle të kujdesshme të sektorit të sigurimeve, do të kërkojë që rezervat dhe provigjonet të kenë një lloj elasticiteti por pjesa më e madhe e riskut të pasqyrës së bilancit përballohet nga kapitali. Sistemet e informacionit në sigurime janë të

rëndësishme, si për qëllime të kontabilitetit të përgjithshëm, për qëllime të raportimit të detyrueshëm, ashtu edhe për menaxhimin efektiv të siguruesve (dhe në veçanti për politikën e çmimeve). Në dekadat e fundit ka pasur një lëvizje drejt bazave të të dhënave relative në mënyrë që analiza e eksperiencës së treguar mund të mbartet bashkë me një numër vektorësh.

Përdorimi i teknikave në rritje të sofistikuar analitike siç janë modelet lineare të përgjithësuara, kanë vendosur gjithashtu presion mbi aksesin dhe përbërjen e të dhënave. Duke pasur në konsideratë këtë ka pasur një varësi mbi sistemet e trashëguara, veçanërisht nga siguruesit e jetës (afatgjatë) të cilët kanë shitur një gamë të gjerë të llojeve të produkteve për vite të tëra. Roli i sistemeve të trashëguara ka qenë një kufizim në racionalizimin e sektorëve të sigurimit të jetës, edhe pse disa zotërues thjesht vendosin biznesin përkatës në likuidim (eng. run off). Biznesi i likuidimeve në fakt është shndërruar në një biznes fitimprurës në disa juridiksione me legjislacionin mbështetës. Shumë prej kompanive të sistemeve të informacionit tashmë ofrojnë sisteme të sigurimeve dhe kjo është shndërruar në një faktor më pak konkurrues gjatë kohërave.

Taksimi i sigurimeve

Kompanitë e sigurimit në mënyrë konceptuale mund të taten në baza të njëjta si çdo ndërmarrje tjetër tregtare. Kjo bëhet mbi fitimet e deklaruar dhe me normën e tatimit mbi korporatat. Për siguruesit e jo-jetës kjo në fakt është metoda e zakonshme, edhe pse një numër vendesh do të lejojnë për vlerësime të rasteve për vendosjen e provigjoneve të dëmeve, më mirë se sa të lejonin dhe për dëmet e ndodhura por jo të raportuara. Kjo reflekton një dëshirë për të qenë në gjendje të auditohen llogaritë e tatimeve dhe të minimizohen qëllimet për kontabilitet kreativ tatimor.

Për sigurimin e jetës pozicioni është shumë më

tepër kompleks, pasi metodologjia e provigjonimit ofron mundësi të konsiderueshme për kreativitet, si dhe përmban kompleksitet dhe për mënyrën se si asetet e policëmbajtësve që kontribuojnë në fitim, duhet të alokohen dhe taksohen. Si rregull policëmbajtësit kanë të drejtë të përfitojnë 90 përqind të përfitimeve që vijnë nga linjat e biznesit që ata mbështesin. Nuk është e pazakontë për regjimet tatimore në tregjet në zhvillim të taksojnë të ardhurat nga investimet duke zbritur shpenzimet e kryera të cilat kanë krijuar atë të ardhur (e ashtuquajtura metoda I-E) sesa mbetjen e deklaruar. Të ardhurat nga investimet që rrjedhin nga biznese të lidhura me aktivitetin e pensione mund të përjashtohen nga taksat. Kjo metodë ka përparësinë për të qenë relativisht objektive por mund të rezultojë në atë që një sigurues që nuk gjeneron fitime, të taksohet dhe të dobësohet më tej.

Shpërndarja dhe ndërmjetësit

Ndërmjetësimi në sigurime vjen në një gamë të gjerë temash:

- o Agjentë të lidhur, ku normalisht përfaqësojnë një sigurues për çdo klasë të sigurimeve.
- o Agjentë të përgjithshëm, të cilët mund të kenë marrëveshje me një numër siguruesish për një klasë të caktuar dhe të cilët punësojnë nën agjentë. Kjo kategori është e ndaluar në shumë vende për shkak të konfuzionit që mund të shkaktojë tek konsumatorët.
- o Brokerat, të cilët përfaqësojnë të siguruarit dhe mund të bëjnë marrëveshje me çdo sigurues. Në shumë vende broker-at mund të marrin komisione nga siguruesi dhe teorikisht atyre mund t'u kërkohej që për këtë të informojnë klientin e tij.
- o Staf i vetë siguruesit shet nga zyrat e vetë siguruesit.
- o “Bancassurance”, ku një bankë vepron gjithashtu direkt për një sigurues ose siguron hapësira për një përfaqësues të siguruesit në tregun e tij me pakicë. Kjo linjë u bë shumë e sukseshme në disa vende si Francë dhe Itali dhe është duke u përdorur në shumë vende të botës, duke qenë se kostot e larta fillestare

- mund të kompensohen nga kostot e ulta të shpërndarjes në afat të gjatë.
- o Qendrat informative telefonike kanë pasur një sukses të përzier por mund të jenë shumë efektive për tregje shumë të specializuara dhe kur janë të lidhura me publicitetin në radio dhe internet. Siç edhe tek “bancassurance”, kostot fillestare mund të jenë shumë të larta.
 - o Bizneset e tjera në të cilën sigurimet janë ndihmëse ndaj biznesit kryesor, siç janë agjentët e udhëtimeve.

Për siguruesit e jo-jetës shpërndarja dhe kostot e marketingut në mënyrë tipike variojnë nga 10% deri në 40% , duke u varur nga fuqia e rrjeteve të ndërmjetësuesve dhe klasës së biznesit. Në mënyrë të veçantë, linjat e detyrueshme kanë një tavan të vendosur në nivelet e komisionit, megjithëse kjo është provuar të jetë e vështirë për t'u zbatuar në disa vende.

Për sigurimin e jetës, marketingu dhe shpërndarja zënë përgjithësisht 70% të kostove totale vjetore. Për sistemet e agjencive kryesore kostot e vendosjes së një police të re në librat e kontabilitetit është në veçanti më shumë së primet e marra gjatë vitit të parë (i ashtuquajtur ndikimi i biznesit të ri (eng. new business strain)) dhe është i rimarrë nga primet e viteve pasardhëse.

Në shumicën e vende industriale dhe në tranzicion agjentët e sigurimeve u duhet të jenë të paktën të regjistruar dhe ka një tendencë në rritje për të kërkuar një nivel trajnimi në proporcion me kompleksitetin e produktit të cilin tregtojnë. Bashkimi Evropian tani ka një direktivë e cila trajton ndërmjetësit në sigurime. Kjo temë është e trajtuar më në detaje të hollësishme në një modul të mëvonshëm.

[1]. WTO – Organizata Botërore e Tregtisë, GATS (General Agreement on Trade in Services) – Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve

Për këtë numër punuan:
E. Shehi, R. Guri, R. Eltari,
E. Zalta, E. Kokona

